



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.656/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e subjekteve politike Nasha Iniciativa, me seli në Mitrovicë, Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat, me seli në Prizren si dhe Nova Demokratska Stranka me seli në Prizren, të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të dt. 04.03.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 07.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHEN pjesërisht të bazuara apelet Anr.656/2021. A.nr.733/2021 dhe A.nr.735/2021 të paraqitura nga subjektet politike Nasha Iniciativa, Unioni Social Demokrat dhe Nova Demokratska Stranka të datës 05.03.2021 kundër vendimit të KQZ-së nr.860-2021 të datës 04.03.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtur me 14 Shkurt 2021.

I. ANULOHEN në tërësi votat për subjektet politike boshnjake në këto Komuna: Zubin Potok, Shtërpcë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Kllokot dhe Novobërdë dhe atë:

Për subjektin politik Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic,

- në Komunën e Zubin Potokut 407 fletëvotime
- në Komunën e Shtërpcës 499 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 255 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 416 fletëvotime
- në Komunën e Parteshit 196 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 249 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 254 fletëvotime

Për subjektin politik Koalicioni - VAKAT

- në Komunën e Shtërpcë 8 fletëvotime
- në Komunën e Ranillukut 211 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 6 fletëvotime
- në Komunën e Parteshit 34 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 9 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 255 fletëvotime

Për subjektin politik Social Demokratska - UNIJA SDU

- në Komunën e Shtërpcës 1 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 4 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 11 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 147 fletëvotime

- në Komunën e Novobërdës 2 fletëvotime

Për subjektin politik Nasha Iniciativa- Nasha

- në Komunën e Shtërpçës 4 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 5 fletëvotime

Për subjektin politik Nova Demokratska Stranka

- në Komunën e Shtërpçës 2 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 1 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 6 fletëvotime
- në Komunën e Klllokotit 2 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 3 fletëvotime

II. ANULOHEN pjesërisht votat për subjektet politike Ujedinjena Zajednica Adrijana Hodzic dhe Koalicioni VAKAT dhe atë:

Për subjektin politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic:

- në Komunën e Zvecanit 157 fletëvotime
- në Komunën e Leposavicit 973 fletëvotime
- në Komunën e Mitrovicës së Veriut 799 fletëvotime

Për subjektin politik Koalicioni - VAKAT:

- në Komunën e Leposavicit 60 fletëvotime

Ndërsa pjesa tjetër e kërkesës në ankesë për anulimin e të gjitha votave përtej pjesës aprovuese si në pikën I-rë dhe II-të, të dispozitivit të këtij vendimi refuzohet e pa bazuar.

III. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, votat e përfshira nga fletëvotimet e anuluarat si në pikën e -I- dhe të -II- dispozitivit të këtij vendimi ti largoj nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 04.03.2021.

A r s y e t i m

Me datën 05.03.2021 PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.656/2021, Anr.733/2021 dhe A.nr.735/2021 të paraqitura nga subjektet politike Nasha Iniciativa, me seli në Mitrovicë, Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat me seli në Prizren si dhe Nova Demokratska Stranka me seli në Prizren, kundër vendimit të KQZ-së, 860-2021 të dt.04.03.2021 në të cilën pretendohet se në zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021, votat e përgjithshme të partive boshnjake shënuan rritje për 49% në krahasim me zgjedhjet e kaluara rreth 6000-7000 vota, me tepër se kudo here tjetër. Një rritje e tillë enorme e votës së përgjithshme boshnjake erdhi për një arsye të vetme ku si asnjëherë me pare mijëra votues të komunitetit serb në Kosovë votuan për përfaqësuesit boshnjak, përderisa në zgjedhjet e vitit 2019 përfaqësuesit boshnjak kishin arritur që ti fitonin bashkërisht në komunat serbe vetëm 195 vota, në zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021, partitë boshnjake fituan në këto komuna 6446 vota që sipas ankuesve kjo është një rritje prej 3205%. Rritja e tillë e votës për përfaqësuesit boshnjak nuk ishte votë e krijuar spontanisht dhe në mënyrë natyrale nga komuniteti serb, në fakt ajo ishte votë tërësisht e manipuluar dhe dirigjuar nga faktorë tjerë. Në këto zgjedhje Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hoxhiq fitoi plotë 6379 vota pa numëruar ato me kusht dhe me postë. Rreth 90% të këtyre votave për këtë parti vijnë nga komunitetit serbe mandej edhe në komunat ku nuk banon as edhe një boshnjak i vetëm partia e Adrijana Hoxhiqit kishte arritur të marre qindra vota, përderisa partitë specifike jo serbe në këtë manipulim Ujedinjena Zajednica - Adrijana

Hoxhiq, Koalicija Vakati dhe Romani Iniciativa morën mbi 9000 vota, nga banoret e komunave serbe. Kjo përputhje numrash nuk mundet të jetë një ko incidencë por dëshmon për një orkestrim të qartë të këtyre votave nga faktorë tjerë. Në provat e bashkangjitura me këtë ankesë vërehet që edhe në komunat me shumicë serbe ku ka fare pak ose edhe asnjë boshnjakë partitë boshnjake Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hoxhiq dhe koalicioni Vakati kanë arritur të sigurojnë një numër të konsiderueshëm të votave.

Kështu votat për Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hoxhiq janë shpërndarë si vijon në këto komuna me shumicë serbe në raport me numrin e popullsisë boshnjake në atë komunë; Komunat e Parteshit numri i votave 183 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 0, në Klllokot numri i votave 248 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 0, në Ranillug numri i votave 244 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 1, në Shtërpce numri i votave 494 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 2, në Novobërdë numri i votave 251 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 5, në Graçanicë numri i votave 385 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 9, në Zubin Potok numri i votave 407, Leposaviq numri i votave 1129, Zveçan numri i votave 454, Mitrovica e Veriut numri i votave 1780.

Ndërsa votat për Koalicionin Vakati, në komunat me shumicë serbe në raport me numrin e popullsisë boshnjake në atë komune janë shpërndarë Komunat e Parteshit numri i votave 34 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 0, në Klllokot numri i votave 9, ndërsa numri i banoreve boshnjakë 0, në Ranillug numri i votave 209 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 1, në Shtërpce numri i votave 7 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 2, në Novobërdë numri i votave 256 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 5, në Graçanicë numri i votave 5 ndërsa numri i banoreve boshnjakë 9, në Zubin Potok numri i votave 0, Leposaviq numri i votave 218, Zveçan numri i votave 1, Mitrovica e Veriut numri i votave 29

Për katër komunat e fundit Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Mitrovica e Veriut nuk kemi në dispozicion të dhëna zyrtare se sa boshnjakë banojnë në to. Sipas të dhënave zyrtare të OSBE-së, e cila është angazhuar zyrtarisht në monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë në këto komuna jetojnë kaq boshnjakë: Zubin Potok 0, Leposaviq 350, Zveçan 300, Mitrovica e Veriut më pak se 1000.

Se numri i boshnjakeve në këtë pjesë të Kosovës nuk është aq i lartë sipas ankuesve ku kjo dëshmohet edhe nga fakti që në zgjedhjet e kaluara 2019 të gjitha partitë boshnjake kanë marrë në këto 4 komuna vetëm 174 vota (me 2017 kanë marrë vetëm 228 vota, kurse me 2014 kanë marrë 328 vota. Nga këto kaq pak vota në zgjedhjet e kaluara është e pamundur që me 2021 vota të përgjithshme legjitime boshnjake të jetë rritur në këto katër komuna 4085 vota, për më shumë se 1200%. Pra edhe në këto komuna ka pasur votim të orkestruar nga komuniteti serb.

Me anë të kësaj ankese kërkohet nga PZAP-i, të ndërmarr veprimet e nevojshme dhe të rishikohen të gjitha vendimet ku ka ardhur deri tek manipulimet me trupin votues në komunat e banuara me shumicë serbe. Po ashtu kërkohet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme kundër individëve dhe partive politike të përfshira në shkeljen e dispozitave ligjore dhe kushtetuese, pasi që Republika e Kosovës dhe të gjithë autoritetet e saj përfshirë edhe PZAP-in, e kanë për obligim kushtetues konform nenit 58(4) të garantojnë pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe vendimmarrje. Një obligim i tillë për Kosovën derivon edhe nga neni 15 i Konventës Kornize të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Mekanizëm kyç në tërë këto struktura pa efikasitetin e të cilit nuk kanë kuptim mekanizmat e tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Kosovës. 20 ulëse nga gjithsejtë 120 janë të garantuara për komunitete jo shumicë sipas nenin 64 par 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat elaborohen edhe nga neni 111 i LZP-se. Këto vende janë të garantuara për komunitetet përkatëse dhe supozohet se vota vjen pikërisht nga komuniteti i njëjtë me atë që deklarohet se përfaqëson komunitetin që konkurren për deputet. Si në Kosovë ashtu edhe gjetiu për realizimin efektiv të demokracisë

konsciacionale nuk mjafton vetëm deklarimi se personi përfaqëson një komunitet të vetëm por duhet të ekzistoj edhe lidhja objektive në mes të këtij deklarimi dhe përkatësisë së dhënë etnike, gjuhësore, fetare, nacionale etj, kjo behet e qartë në praktiken gjyqësore evropiane për te drejtat e njeriut, që sipas nenit 53 të Kushtetues zbatohet nga çdo autoritet publik në Kosove. Në rastin konkret të zgjedhjeve të datës 14.02.2021 nuk mund të gjendet asnjë lidhje objektive në mes të deklarimit të atyre që thonë se kanë marrë votat e boshnjakeve dhe votës së marre në emër të tyre, sepse behet fjalë për vendvotime dhe vota të votuese ku komuniteti boshnjak dhe jo serb është tërësisht marginal dhe i papërfillshëm numerikisht. Në qendër të dizajnit kushtetues kosovar sa i përket përfaqësimit efektiv të komuniteteve qëndrojnë padiskutueshëm ulëset e garantuara të komuniteteve në Kuvend, ku shumë të drejta dhe mekanizma të përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, varen nga përfaqësimi i garantuar i komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, ku pa këto ulëse të garantuara komunitetet nuk mund të marrin pjesë efektivisht në jetën publike. Zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021 sollën një situatë ku realisht përfaqësimi i komunitetit boshnjak nuk do të behet në mënyrë adekuate dhe efektive në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit, andaj këto ulëse kanë për qëllim të garantojnë vetëm përfaqësim efektiv dhe real të një komuniteti të caktuar. Përfaqësuesit nga komuniteti boshnjak janë të projektuar të zgjedhën deputet në ulëset e garantuara si rezultat i votave të një komuniteti tjetër i cili numerikisht është më i madh se ai boshnjak, pra ekziston një shkopë në mes të përfaqësuesve të komuniteti boshnjak dhe elektoratit të këtij komuniteti, që sipas Kushtetutës dhe LZP-së, duhet ti jap legjitimitetin përfaqësues të deputetit në rend të parë. Andaj, një deformim i tillë i këtij mekanizmi përfaqësues mohon çfarëdo përfaqësimi efektiv të komunitetit boshnjak në Kosovë dhe është në kundërshtim me nenin 58 (4) dhe 64 (2) të Kushtetutës së Kosovës. Në anën tjetër nuk mund të konsiderohet i qëndrueshëm argumenti që përfaqësuesit që zënë ulëset e komunitetit boshnjak, e që është zgjedhur me votat e komunitetit serb, vetëm pse është i përkatësisë boshnjake, dhe do të përfaqësoj interesat e komunitetit boshnjak në mënyrë adekuate. Kjo bie ndesh me definimin e komuniteteve me nenin 57 (1) të Kushtetutës së Kosovës, duke mos qenë të zgjedhur nga komuniteti boshnjak, përfaqësuesit që do të zënë ulëset e garantuara për komunitetin boshnjak nuk do të kenë iniciativën e duhur dhe kujdesin për interesat e komunitetit boshnjak, andaj si rezultat i kësaj situatë nuk mund të flasim për përfaqësim të interesit boshnjak dhe tolerimin e një situatë të tillë, padyshim do të kemi shkelje të nenit 58 par.4) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave ndërkombëtare, zbatimi i së cilës garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës. Po qëse tolerohet mundësia që një komunitet të zgjedhë përfaqësuesin e komunitetit tjetër vetëm pse e ka një mundësi të tillë për shkak të numrit më të madh të qytetarëve, atëherë kjo mohon çfarëdo barazie të mundshme në jetën politike në mes të komuniteteve. Madhësia e komuniteteve është marrë parasysh me rastin e bërjes së Kushtetutës aktuale, ku varësisht nga numri i popullsisë edhe është caktuar numri i ulëseve të rezervuara. Andaj, kërkojmë nga PZAP-i në këtë rast të përdorë logjikën e njëjtë të arsyetimit sikurse në disa vendime të tij të mëparshme në të cilat kishte aprovuar mos certifikimin nga KQZ-ja të disa kandidatëve shqiptar për deputet në partitë boshnjake, duke qenë se partitë boshnjake garonin për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës konform LZP-së. Pra njësoj sikurse që pjesëtarët e një komuniteti nuk mund të garojnë për vendet e komunitetit tjetër, ashtu edhe votat e pjesëtarëve serb nuk do duhej të lejohen nga PZAP të numërohen në rezultatin final që kanë arritur të gjitha partitë boshnjake pa përjashtim. Vetëm kështu PZAP do garantonte integritetin e zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021, rendin kushtetues, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të komunitetit jo shumicë. Andaj, parashtruesit e apeleve kërkojnë nga PZAP-i që ti anuloj pjesërisht të gjitha vendvotimet në komunat me shumicë serbe vetëm për atë sa ato vota kanë shkuar për gjitha partitë boshnjake duke qenë se numri i popullsisë boshnjake në këto komuna si ne Partesh, Kllokot Ranillug, Shtërpçë Novobërdë dhe Graçanicë, ku sipas matjeve zyrtare është zero ose i pa përfillshëm, si dhe anulimin e pjesërishtëm edhe të të gjitha vendvotimeve në komunat me shumicë serbe si Zubin Potok

Leposaviq Zveçan dhe Mitrovica e Veriut megjithëse nuk dihet zyrtarisht se sa pjesëtar të komunitetit boshnjak jetojnë aty.

Në përgjigjen e saj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuuese, në lidhje me kërkesën e PZAP-it, njofton si në vijim: “Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin punës, si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimin, hetimin e Formularëve e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, Formularët e Rezultateve të Kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevantë”.

Në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 06/2013, secili Formular i Rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve.

Nga auditimi që i është bërë Formularëve të Rezultateve, rezulton se ka pasur probleme të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve, kur krahasohen me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota.

Procedura e QNR-së, nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Po ashtu, në rastet kur subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim.

Gjatë procesit të auditimit kontrollohen të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgatitet raporti. Andaj, mbi bazën e të gjeturave nga raporti i auditimit, QNR, i ka rekomanduar KQZ-së, që një pjesë e vendvotimeve të caktuara, e të cilat kanë pasur probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Një gjë e tillë ka ndodhur gjithmonë edhe në të kaluarën, kur është mundësuar korrektimi i secilit lëshim që është vërejtur në proces, po ashtu edhe në këto zgjedhje.

Formularët të cilët nuk kanë përputhje matematikore nuk mund të procedohen si të rregullt (këtë nuk e lejon sistemi i përpunimit të të dhënave) dhe i njëjti do t'i nënshtrohet auditimit në QNR, dhe varësisht nga rezultati, eventualisht edhe rinumërimit.

Në QNR, procedohen të dhënat nga Formularët e Rezultateve nga subjektet dhe kandidatët e tyre, në bazë të të dhënave që janë në FRK dhe FPR.

Andaj, KQZ-ja, është e obliguar që të procedoj formularët e proceduar në mënyrë të rregullt dhe rezultatin i cili është i pasqyruar në FRK dhe FPR. Ndërsa, gjatë procedimit të materialit zgjedhor KQZ-ja, nuk ka autorizim që të vlerësoj se si kanë votuar komunitetet dhe për kënd kanë votuar.

Andaj, konsiderojmë së ankesa ka të bëjë me të drejtat kushtetuese, dhe jo procedurale, pra KQZ-ja, nuk është kompetente të bëjë interpretime kushtetuese, por vetëm bënë organizimin e zgjedhjeve në mënyrë teknike dhe procedurale.

Andaj, i gjithë materiali zgjedhor i cili gjendet në QNR, nëse PZAP, konstaton dhe konsideron të nevojshme mund të bëjë hetim dhe verifikim të gjendjes faktike.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.656/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hirë të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndëve, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë pjesërisht të bazuara

Paneli, me datë 06.03.2021, sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar gjendjen faktike dhe erdhi në përfundim se ankesat janë pjesërisht të bazuara, për arsye se:

Votat e marra nga Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe Koalicioni - VAKAT, në disproporcion me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak, komunitet që i përkasin edhe subjektet ankuese por edhe subjekti i atakuar, paraqesin vota të pa vlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komunitetit të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komuniteti tjetër dhe si të tilla nuk paraqesin lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar.

Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, subjekte të caktuara si në këtë rast Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe Koalicioni - VAKAT kanë marrë shumicën e votave nga komuniteti serb, gjë që në këtë rast paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit boshnjak, e krejt kjo në thelb paraqet minim të procesit zgjedhor por edhe të integritetit të këtij procesi.

Sipas vlerësimit të Panelit, minimi i procesit zgjedhor përmes votimit në këtë mënyrë të orkestruar për subjekte të caktuara për të zgjedhur përfaqësuesit e komunitetit boshnjak, përveç devijimit të vullnetit të votuesit, kjo në vetvete cenon demokracinë e brendshme zgjedhore, eliminon garën në mes të subjekteve për vendet e garantuara dhe krejt kjo është në kundërshtim me nenin 111.1 të LZP-së, nenin 58.4 të Kushtetutës së Kosovës dhe parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane.

E drejta e votës dhe liria e votimit sipas vlerësimit të Panelit, në rastin e vendeve të rezervuara nuk është identike me rastin e vendeve jo të rezervuara, pasi për vendet e rezervuara është me rëndësi lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar, dhe vetëm kështu sigurohet e drejta e përfaqësimit në kuptim të dispozitave të LZP-së, dhe në frymën e dispozitave dhe standardeve kushtetuese.

Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese të cilat Republika e Kosovës i ka marr, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore.

Se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara e të cilat vota janë fituar nga votues të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar, kjo vërtetohet nga numri i banorëve në krahasim me numrin e votave të marra, ndërsa numri i banorëve pasqyrohet përmes të dhënave të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së.

Po ashtu, në raport me pakicat ekzistojnë standarde ndërkombëtare sipas të cilave shtetet përkatëse duhet të themelojnë praktika apo mekanizma të atillë, që u mundësojnë pjesëtareve të pakicave votim të lirë, krijimin të subjekteve të tyre si dhe parandalimin e çdo lloj diskriminimi për të zgjedh dhe për tu zgjedhur.

Është fakt notor se përqindja e qytetarëve të komunitetit boshnjak, shqiptar, etj, nuk ka shënuar rritje në këto komuna si: Mitrovicë e Veriut, Zvecan, Zubin Potok dhe Leposavic, për shkak të rrethanave dhe funksionimit të këtyre komunave.

Nga raporti i OSBE-së, i vitit 2018 (i cili raport merret i besueshëm, për shkak se është organizatë kredibile, dhe ka qëndrim neutral ndaj të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës) numri i banorëve të komunitetit boshnjak në komunat veriore është si vijon: Mitrovicë e Veriut 1,000 banorë, Zvecan 300, Zubin Potok nuk ka, Leposavic 350 banorë, ndërsa numri i votave për komunitetin boshnjak në këto Komuna është në disproporcion me numër të banorëve.

Tendenca për krijimin e praktikave të tilla të votimit masiv nga pjesëtarët e njërit komuniteti për subjektin e komunitetit tjetër, paraqet praktikë të rrezikshme e cila në të ardhmen do të mund të shfrytëzohej nga komuniteti shumicë, për t'ia pamundësuar të drejtën e përfaqësimit në mënyrë objektive komuniteteve tjera pakicë.

Anulimi i pjesshëm i votave për subjektet e cekura si në dispozitiv të këtij vendimi, ka për qëllim ruajtjen dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit, në raport me përqindjen e popullsisë nga ky komunitet sikurse garantohet me ligj dhe Kushtetutë.

Përveç të cekurave si më lartë, për të ardhur në një përfundim të tillë, Paneli, vlerësoi dhe mori për bazë në mënyrë krahasimore edhe të dhënat për votuesit në zgjedhjet paraprahe (2017 dhe 2019) në raport me zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021.

Paneli, duke iu referuar të gjeturave të konstatuara më lartë vendosi si në pikën I-rë dhe të II-të të dispozitivit të këtij vendimi e në veçanti duke u bazuar në raportet e OSBE-së, për strukturën demografike të popullsisë boshnjake nga të cilat rezulton se në vitin 2018 komuniteti boshnjak ka pasur numër të banorëve si në vijim dhe atë: në Komunën e Zvecanit 300 banorë, në Komunën e Parteshit asnjë banor, në Komunën e Ranillugut 1 banor, në Komunën e Mitrovicës së Veriut 1,000 banorë, në Komunën e Novobërdës 5 banor, në Komunën e Zubin Potokut asnjë banor, në Komunën e Klllokotit asnjë banor, në Komunën e Graqanices 15 banor, në Komunën e Shtërpçës 2 banor dhe në Komunën e Leposavit 350 banor.

Ndërsa nëse i referohemi rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të datës 14 Shkurt 2021, rezulton se subjekti Koalicioni – VAKAT, në këto zgjedhje ka marrë këtë numër të votave dhe atë: në Zvecan 1 votë, Zubin Potok 0 vota, Shtërpçë 8 vota, Ranillug 211 vota, Graqanicë 6 vota, Partesh 34 vota, Klllokot 9 vota, Novobërdë 255 vota, Leposavic 218 vota dhe Mitrovicë Veriore 34 vota; subjekti Socialdemokratska Unija – SDU, në këto zgjedhje ka marrë këtë numër të votave dhe atë: në Zvecan 0 votë, Zubin Potok 0 vota, Shtërpçë 1 vota, Ranillug 4 vota, Graqanicë 11 vota, Partesh 0 vota, Klllokot 147 vota, Novobërdë 2 vota, Leposavic 25 vota dhe Mitrovicë Veriore 7 vota; subjekti Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic në këto zgjedhje ka marrë këtë numër të votave dhe atë: në Zvecan 455 votë, Zubin Potok 407 vota, Shtërpçë 499 vota, Ranillug 255 vota, Graqanicë 416 vota, Partesh 196 vota, Klllokot 249 vota, Novobërdë 254 vota, Leposavic 1131 vota dhe Mitrovicë Veriore 1724 vota; subjekti Nova Demokratska Stranka në këto zgjedhje ka marrë këtë numër të votave dhe atë: në Zvecan 0 votë, Zubin Potok 0 vota, Shtërpçë 2 vota, Ranillug 1 vota, Graqanicë 6 vota, Partesh 0 vota, Klllokot 2 vota, Novobërdë 3 vota, Leposavic 7 vota dhe Mitrovicë Veriore 22 vota, subjekti Nasa Inicijativa - NASA në këto zgjedhje ka marrë këtë numër të votave dhe atë: në Zvecan 1 votë, Zubin Potok 0 vota, Shtërpçë 4 vota, Ranillug 0 vota, Graqanicë 5 vota, Partesh 0 vota, Klllokot 1 vota, Novobërdë 0 vota, Leposavic 2 vota dhe Mitrovicë Veriore 12 vota.

Paneli, vendosi si në pikën I-rë të dispozitivit të këtij vendimi, në 7 (shtatë) komunat e lartcekura duke anuluar në tërësi të gjitha votat e fituara nga të gjitha subjektet politike boshnjake, për arsye se votat e fituara janë në disproporcion dhe nuk korrespondojnë me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak si dhe për arsyet e cekura si më lartë.

Paneli, vendosi si në pikën II-të të dispozitivit të këtij vendimi, në 3 (tri) komunat e lartcekura duke anuluar pjesërisht votat e fituara nga subjektet politike boshnjake, duke iu referuar raporteve të lartcekura, duke marr për baze strukturën demografike të popullsisë, gjegjësisht numrin e banorëve në raport me maksimumin e votave që do të mund të fitonin subjektet politike boshnjake në proporcion me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak, si dhe për arsyet e cekura më lartë.

Në raport me pjesën refuzuese pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse kërkesën, sepse anulimi i të gjitha votave edhe në komunat ku përqindja e popullsisë së pjesëtarëve të komunitetit boshnjak është më e lartë, do të përbënte anulim të pa bazuar të fletëvotimeve të vlefshme, pasi jo të gjitha votat për komunitetin boshnjak kanë qenë të orkestruara.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.656/2021 më datë 07.03.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, brenda afatit 24 orë nga dita e pranimit, në Gjykatën Supreme.